

STATUTI I SHOQËRISË

“KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE” SH.A.

HYRJE

Më poshtë, gjendet Statuti i Korporatës së Investimeve Shqiptare, hartuar në përputhje me ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare,” dhe ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Aktet nënligjore dhe procedurat specifike që kanë të bëjnë me operacionet dhe investimet, financat dhe auditimin, kodet e qeverisjes dhe etikës, burimet njerëzore dhe aktivitetet e tjera miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës, sipas nevojës.

MISIONI

Misioni i Korporatës së Investimeve Shqiptare është zhvillimi ekonomik i Shqipërisë. Korporata është një kapacitet i shtetit, me autonomi operacionale, e cila ka për qëllim identifikimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e projekteve të investimeve me potencial komercial, duke rivitalizuar asetet shtetërore dhe duke mobilizuar kapitalin privat. Korporata është pjesë e strategjisë për të sjellë një rritje të qëndrueshme të Shqipërisë.

TITULLI I

EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE OBJEKTI

Neni 1

Forma e Organizimit

1. Shoqëria emërtohet “Korporata e Investimeve Shqiptare” SH.A. (këtej e tutje referuar si, “Korporata”).
2. Korporata është një shoqëri aksionare, me oferte private, në bazë të ligjit Nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare,” dhe ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.
3. Korporata ka stemën, logon, dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 2

Selia

1. Selia e Korporatës është në Adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, Shqipëri.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të hapë dhe/ose të mbyllë shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Korporatës është e pakufizuar.

Neni 4 Objekti

Objektivat kryesore të veprimtarisë së Korporatës janë:

1. Nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit me potencial komercial në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
2. Vënia në përdorim me eficiencë të pronave shtetërore.
3. Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.
4. Këshillimi i institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, rekomandimin, dhe strukturimin e projekteve.
5. Zhvillimi i Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, me vendim/autorizim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik.
6. Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre.
7. Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

TITULLI II KAPITALI DHE AKSIONET

Neni 5 Kapitali

1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Korporatës është 198 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion) lekë, i përbërë nga 100 aksione të zakonshme, me vlerë nominale prej 1 980 000 lekësh secili.
2. Në çastin e themelimit, kapitali është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, si më poshtë vijon:
 - shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka kontribuar në para në kapitalin e Korporatës, me një shumë të barabartë prej 198 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion) lekësh.
3. Në çastin e themelimit, bazuar në kontributet e sipërpërmendura, shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Korporatës (këtej e tutje referuar si "Aksioneri i vetëm").

Neni 6 Aksionet

1. Aksionet e Korporatës janë të zakonshme dhe regjistrohen në regjistrin e aksioneve.
2. Një akt emetimi aksionesh hartohet në momentin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban informacionet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Institucionet Ndërkombëtare Financiare të Zhvillimit mund të zotërojnë aksione në Korporatë. Procedurat, kriteret dhe formula e pjesëmarrjes së tyre përcaktohen me

vendim të Këshillit të Ministrave. Aksionerët e rinj kanë të drejtë të kërkojnë amendime në Statut për të reflektuar ndryshimet në përbërjen e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve.

Neni 7 Transferimi i aksioneve

Transferimi i aksioneve tek të tretët i nënshtrohet miratimit të aksionerit që ka shumicën e aksioneve dhe kryhet në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 8 Ndryshimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë apo zvogëlojë kapitalin e Korporatës në zbatim të këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Kontributet e reja për zmadhimin e kapitalit mund të konsistojnë në para ose pasuri dhe të drejta të vlerësueshme në para. Kontributet nuk mund të jenë në punë apo shërbime.

TITULLI III ORGANET E KORPORATËS DHE ADMINISTRIMI

Neni 9 Organet e Korporatës

Organet drejtuese të Korporatës janë:

1. Asambleja e Përgjithshme (Asambleja).
2. Këshilli Mbikëqyrës (Këshilli).
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Bordi Këshillimor (Bordi).

Neni 10 Asambleja e Përgjithshme (Asambleja)

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë ushtrohen nga Ministri përgjegjës për ekonominë, në cilësinë e aksionerit të vetëm, deri në momentin kur miratohen aksionerë të tjerë sipas nenit 4 të ligjit 71/2019.
2. Ne momentin kur shtohen aksionerët, bëhen ndryshimet në Statut lidhur me të drejtat dhe detyrimet reciproke të tyre dhe në lidhje me Korporatën.
3. Asambleja merr vendime për çështjet e mëposhtme:
 - a) miratimin e Statutit të Korporatës dhe ndryshimeve të tij;
 - b) miratimin e strategjisë (politikat tregtare);
 - c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
 - d) emërimin e lirimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Këshillimor;
 - e) emërimin e lirimin e likuiduesve dhe audituesve;
 - f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

- g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre, si dhe ndryshime në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- h) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- i) riorganizimin dhe prishjen e Korporatës;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- k) përfaqësimin e Korporatës në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- l) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo Statuti.

Neni 11

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja mblidhet çdo vit në një mbledhje të zakonshme të planifikuar, brenda muajit Qershor, për të kryer funksionet e përcaktuara në ligjin dhe aktet nënligjore të Korporatës, si dhe sa herë që e kërkon interesi i Korporatës.
2. Asambleja mblidhet ne seancë të veçantë me iniciativë të aksionerëve, Këshillit Mbikëqyrës ose Drejtorit Ekzekutiv.
3. Asambleja mblidhet në seancë të veçante nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo është e qartë një humbje prej 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit, apo nëse ekziston rreziku se Korporata gjatë veprimtarisë së saj nuk do të jetë në gjendje të mbulojë detyrimet e saj brenda 3 (tre) muajve të ardhshëm.
4. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë bëhet të paktën 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar se mbledhjes, dhe ju komunikohet palëve të interesuara me postë të zakonshme dhe postë elektronike.
5. Në njoftim jepen:
 - a) emërtimi dhe selia e Korporatës dhe lloji i mbledhjes;
 - b) rendi i ditës, vendi, data dhe koha e thirrjes se Asamblesë;
 - c) programi dhe procedurat.
6. Asambleja mblidhet në selinë kryesore të Korporatës, ose në ndonjë vend tjetër të caktuar nga aksioneri(et). Asambleja mund të mbajë mbledhjet edhe nëpërmjet telekonferencës apo mjeteve të ngjashme të komunikimit.
7. Mbledhja e Asamblesë mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave të pranishëm në vende të ndryshme, të lidhur nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, në përputhje me metodat e zakonshme të telekomunikimit, ku përfshihen mjetet elektronike, me kusht që të gjithë aksionarët, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo mjeteve të ngjashme elektronike, të identifikohen dhe atyre t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë drejtpërdrejt në çështjet e trajtuara dhe për të marrë, dërguar ose shqyrtuar dokumentet.

Neni 12

Rendi i ditës në Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje për të cilën Asambleja merr një vendim.
2. Asambleja nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
3. Aksionerët kanë të drejtë të përfaqësohen nga një person tjetër, në bazë të një prokure/autorizimi me shkrim. Në çdo rast, prokura/autorizimi jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë.

4. Në mbledhjen e Asamblesë mund të marrin pjesë edhe anëtarët e organeve të tjera drejtuese, Drejtori Ekzekutiv dhe zyrtarë të Korporatës.
5. Drejtori Ekzekutiv dhe anëtarët e organeve drejtuese nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Asamble.
6. Sekretari i Korporatës shërben edhe si Sekretar për Asamblenë.

Neni 13 Protokolli

1. Çdo vendim i Asamblesë regjistrohet në procesverbal. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen dhe ruajtjen e procesverbaleve.
2. Në procesverbal shënohen të dhënat në vijim:
 - vendi dhe data e mbledhjes;
 - rendi i ditës;
 - vendimet e marra.
3. Procesverbalit i bashkëngjiten lista e pjesëmarrësve, si dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë.
4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve nënshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Sekretari është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes në faqen e internetit të Korporatës.
6. Organet drejtuese dhe zyrtarët e Korporatës ngarkohen me zbatimin e vendimeve të Asamblesë.

Neni 14 Këshilli Mbikëqyrës (Këshilli)

1. Këshilli përbëhet deri në shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja. Tre nga anëtarët e Këshillit janë nga institucionet qendrore dhe katër janë të pavarur. Numri i anëtarëve të Këshillit rritet në momentin kur Korporatës i shtohen aksionerë të tjerë. Anëtarët e pavarur përbëjnë shumicën e anëtarëve të Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Korporatën.
3. Anëtarë të Këshillit zgjidhen ata persona që:
 - a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotërojnë të paktën gradën "master shkencor" ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) kanë shtetësi Shqiptare ose të huaj.
4. Anëtarët zgjidhen duke patur parasysh komplementimin e ekspertizave të nevojshme për funksionimin me efektivitet të Këshillit.
5. Shpërblimi për anëtarin e Këshillit nuk është më pak se 1/3 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.
6. Anëtarët e Këshillit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla të shoqërive tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15
Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Anëtarët e Këshillit emërohen në detyrë për një afat jo më të gjatë se tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Asambleja duhet të marrë në konsideratë rotacionin e anëtarëve në momentin e rizgjedhjes për të siguruar dinamizëm por edhe vazhdimësi në funksionimin e Korporatës.
3. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij, ose mungon në më shumë se katër mbledhje, atëherë Asambleja liron/shkarkon këtë anëtar dhe emëron një anëtar të ri për të shërbyer për pjesën e mbetur të mandatit në detyrë.
4. Një ose më shumë anëtarë mund të lirohen/shkarkohen, me shkak, nga Asambleja. Rastet e lirimit/shkarkimit përfshijnë neglizhencën në kryerjen e detyrave, shkeljen e rëndë të rregullave të brendshme dhe cënimin e interesit të Korporatës, dënimin nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre ose kundravajte penale, falimentimin, ndalimin ose pezullimin nga gjykata për ushtrimin e detyrës si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrisë veprimtarinë apo mjeshtërinë, marrjen pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike gjatë kryerjes së detyrës.
5. Cdo anëtar i Këshillit mund të japë dorëheqjen, në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Asamblesë ose Sekretarin e Korporatës. Dorëheqja hyn në fuqi në kohën e përcaktuar në të.

Neni 16
Kryetari dhe Nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli zgjedh midis anëtarëve të tij Kryetarin dhe Nënkryetarin, një nga të cilët duhet të jetë anëtar i pavarur, të cilët kanë si detyrë thirrjen e mbledhjeve të Këshillit, përcaktimin e programit të mbledhjes, si dhe drejtimin e diskutimeve. Ata zgjidhen për gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen.
1. Në mungesë të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Nënkryetari, ose në mungesë të Nënkryetarit, nga një anëtar tjetër i Këshillit me vendim të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Sekretari i Korporatës shërben edhe si Sekretar për Këshillin.

Neni 17
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli siguron që Korporata gëzon autonomi operationale në veprimtarinë e saj, dhe ka këto kompetenca:
 - a) propozon për miratim pranë Asamblesë Statutin e Korporatës dhe ndryshimet në të;
 - b) propozon për miratim pranë Asamblesë strategjinë (politikat tregtare) e Korporatës;
 - c) miraton planin e biznesit, buxhetin, dhe planet vjetore të punës;
 - d) miraton projektet e investimit;
 - e) miraton ngritjen e strukturave të tjera të Korporatës;
 - f) kontrollon zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;
 - g) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;

- h) kujdeset që Korporata të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - i) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo Statutit, kryhen me saktësi nga Korporata;
 - j) siguron që auditimi i pavarur të kryhet të paktën një herë në vit;
 - k) emëron dhe liron Drejtorin Ekzekutiv dhe zyrtarët e Korporatës;
 - l) përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe administratës së Korporatës;
 - m) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Korporatë, dhe për çështje të tjera;
 - n) miraton procedurat dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve;
 - o) miraton aktet e brendshme të Korporatës.
2. Këshilli bashkëpunon me Bordin Këshillimor në marrjen e vendimeve.
 3. Këshilli përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ligji nr. 71/2019, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Statuti i Korporatës, dhe aktet e tjera të brendshme.

Neni 18

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Të gjitha mbledhjet e Këshillit mbahen në selinë e Korporatës ose në një vend tjetër, sipas kërkesës së drejtuesit të mbledhjes ose të shumicës së anëtarëve.
2. Këshilli mbledhet rregullisht të paktën një herë në 3 (tre) muaj, si dhe sa herë që e kërkon interesi i Korporatës.
3. Këshilli mbledhet në një seancë të veçantë me kërkesë të Kryetarit apo dy prej anëtarëve të tij, ose me iniciativën e Drejtorit Ekzekutiv.
4. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të marrë pjesë në një takim personalisht, Këshilli do të lehtësojë lidhjet me mjete të tjera të mundshme, përfshirë telekonferencën ose mjete të ngjashme të komunikimit.
5. Kuorumi për mbledhjet e Këshillit arrihet nëse katër nga shtatë anëtarët e tij janë të pranishëm, dy nga të cilët duhet të jenë anëtarë të pavarur, personalisht ose përmes lidhjeve të tjera, si telekonferencë ose mjete të ngjashme të komunikimit.
6. Një shumicë e anëtarëve të pranishëm, pavarësisht nëse është pjesë e një kuorumi, mund të shtyjnë mbledhjen në një kohë dhe vend tjetër, duke njoftuar te gjithë anëtarët.
7. Mbledhjet e Këshillit mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës apo me mjete të ngjashme të komunikimit, me kusht që anëtarët e tjerë të kenë mundësi të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara. Në këtë rast, mbledhja e Këshillit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet drejtuesi i mbledhjes.

Neni 19

Aftësia për të vepruar gjatë periudhës midis mbledhjeve

1. Këshilli mund të përdorë të gjitha mjetet e mundshme të komunikimit për të ushtruar funksionet e tij, në rast pamundësie të organizimit të mbledhjeve.
2. Gjatë periudhës ndër-sesionale, Këshilli vazhdon të ushtrorë funksionet e tij dhe të kryejë aktivitetet, sipas nevojës.

3. Këshilli mund të kërkojë nga Sekretari ndihmë për kryerjen e funksioneve të tij. Sekretari ka detyrimin të respektojë kërkesën e Këshillit për ndihmë.
4. Këshilli ka të drejtën të marrë ekspertizë të jashtme në kryerjen e funksioneve. Në këtë rast nevoja e ekspertizës duhet të argumentohet qartë.

Neni 20 **Njoftimi i Mbledhjes**

1. Njoftimi i mbledhjes, i nënshkruar nga pala apo palët thirrëse, në të cilin përcaktohen ora, dita, vendi, si dhe rendi i ditës, duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit nëpërmjet postës së zakonshme dhe postës elektronike të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen. Ky afat mund të zvogëlohet në 48 (dyzet e tetë) orë, në raste urgjence.
2. Mbledhja e Këshillit quhet e thirrur rregullisht edhe pa përmbushur këto formalitete, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit janë të pranishëm në mbledhje.
3. Pala apo palët thirrëse vënë, gjithashtu, në dispozicion të çdo anëtari të Këshillit të gjithë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, për çështjet që trajtohen, të paktën 7 (shtatë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen dhe, në rast urgjence, 48 (dyzet e tetë) orë përpara.

Neni 21 **Vendimarrja**

1. Këshilli synon të marrë vendime bazuar në konsensus. Në rast kur nuk mund të arrihet konsensus, Këshilli merr vendimet me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Në rast barazie votash, vota e drejtuesit të mbledhjes është vendimtare.
3. Zyrtarët e Korporatës ngarkohen me zbatimin e vendimeve të marra nga Këshilli.

Neni 22 **Protokolli**

Sekretari mban procesverbale të mbledhjeve të Këshillit.

Neni 23 **Drejtori Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv i Korporatës emërohet dhe lirohet nga detyra me vendim të Këshillit.
2. Drejtori Ekzekutiv emërohet në detyrë, për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet.
3. Drejtori Ekzekutiv i raporton Këshillit rregullisht dhe sa herë që ky Këshill e kërkon.
4. Drejtor Ekzekutiv emërohet personi që:
 - a) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotëron të paktën gradën "master shkencor" ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) është shtetas Shqiptar ose i huaj.

5. Paga e Drejtorit Ekzekutiv është konkurruese në raport me tregun, kredencialet dhe performancën në detyrë.

Neni 24

Emërimi i Drejtorit Ekzekutiv

1. Këshilli krijon një komitet rekrutimi, me jo më shumë se tre anëtarë, nga të cilët dy janë anëtarë të pavarur, për të rekrutuar Drejtorin Ekzekutiv. Vendimet merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.
2. Këshilli fton dy anëtarë nga Bordi Këshillimor për të shërbyer në komitetin e rekrutimit pa të drejtë vote.
3. Komiteti detajon termat e referencës për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv dhe përgatit draftin e kontratës në lidhje me termat dhe kushtet e punës.
4. Komiteti mund të marrë konsulence të specializuara të jashtme për të asistuar në procesin e rekrutimit.
5. Rekrutimi bazohet në një proces konkurrues për të vlerësuar kandidatët duke përdorur kriteret e përcaktuara në ligj dhe të përpunuar në termat e referencës për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv.
6. Komiteti i rekomandon Këshillit tre kandidatët kryesorë për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv.
7. Drejtori Ekzekutiv shërben në diskrecionin e Këshillit, për një periudhë tre vjeçare, i nënshtrohet treguesve kryesorë të performancës dhe kontratës, dhe nuk rrimërohet në pozicion më shumë se një herë. Këshilli liron/shkarkon Drejtorin Ekzekutiv në përputhje me treguesit e performancës dhe kontratës, e cila duhet të përfshijë edhe kushtet e lirim/shkarkimit sipas pikës 4 të nenit 15 të këtij Statuti.

Neni 25

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Korporatës.
2. Drejtori Ekzekutiv kryen administrimin e zakonshëm të Korporatës, brenda kufijve të vendosur nga ligji, Statuti dhe aktet e brendshme, dhe kompetencat e deleguara shprehimisht nga Këshilli.
3. Drejtori Ekzekutiv mund të marrë pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese të Korporatës.
4. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë dhe detyrohet, por pa u kufizuar:
 - a) të administrojë veprimtarinë e Korporatës;
 - b) të përfaqësojë Korporatën në marrëdhënie me të tretët;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël;
 - d) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
 - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën, në bashkëpunim me Komitetin e Investimeve;
 - f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) të raportoje përpara organeve drejtuese për zbatimin e politikave, planeve të punës, dhe projekteve të investimit;
 - h) të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë, Këshillit, legjislacionit dhe akteve të brendshme të Korporatës;
 - i) të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të organeve drejtuese të Korporatës.
5. Drejtori Ekzekutiv bashkëpunon me Bordin Këshillimor për të propozuar projekte investimi për miratim në Këshill dhe në zbatimin e planit të biznesit, buxhetit dhe planit vjetor të punës.
6. Drejtori Ekzekutiv përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ligji nr. 71/2019, detyra të tjera që kryen administratori, sipas përcaktimeve të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe Statuti dhe aktet e brendshme.

Neni 26

Emërimi i Drejtorit Ekzekutiv të Parë

1. Në bazë të ligjit nr. 71/2019, dhe nenit 115 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, Drejtor Ekzekutiv i parë caktohet z. Ermal Frashëri, shtetas shqiptar, lindur më 31.10.1974, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034265623, banues në adresën: Rruga e Durrësit, P. 7, Apt. 6, Tiranë.
2. Drejtori Ekzekutiv i parë zgjidhet deri në përfundim të procedurës së konkurrit që do zhvillohet nga Këshilli për emërimin përfundimtar të Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 27

Bordi Këshillimor (Bordi)

1. Bordi përbëhet nga nëntë anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja. Tre anëtarë janë nga institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare të Zhvillimit, dhe katër anëtarë të tjerë janë të pavarur.
2. Anëtarët e Bordit zgjidhen ata persona që:
 - a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotërojnë të paktën gradën “master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) kanë shtetësi Shqiptare ose të huaj.
3. Anëtarët zgjidhen duke patur parasysh që Bordi të ketë në përbërjen e tij anëtarë me ekspertizën e nevojshme për funksionimin me efektivitet të tij.
4. Shpërblimi për anëtarin e Bordit nuk është më pak se 1/4 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 28

Mandati i anëtarëve të Bordit Këshillimor

1. Anëtarët e Bordit emërohen në detyrë, për një afat jo më të gjatë se tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Asambleja duhet të marrë në konsideratë rotacionin e anëtarëve në momentin e rizgjedhjes për të siguruar dinamizëm por edhe vazhdimësi në funksionimin e Korporatës.
3. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij, ose mungon në më shumë se katër mbledhje, atëherë Asambleja liron/shkarkon këtë anëtar dhe emëron një anëtar të ri për të shërbyer për pjesën e mbetur të mandatit në detyrë.
4. Një ose më shumë anëtarë mund të lirohen/shkarkohen, me shkak, nga Asambleja, duke ndjekur të njëjtat procedura dhe shkaqe të përcaktuara në këtë Statut për anëtarët e Këshillit.
5. Çdo anëtar i Bordit mund të japë dorëheqjen, në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Asamblenë ose Sekretarin e Korporatës. Dorëheqja hyn në fuqi në kohën e përcaktuar në të.

Neni 29

Kryetari dhe Nenkryetari i Bordit Këshillimor

2. Bordi zgjedh midis anëtarëve të tij Kryetarin dhe Nenkryetarin, një nga të cilët duhet të jetë anëtar i pavarur, të cilët kanë si detyrë thirrjen e mbledhjeve të Bordit, përcaktimin e programit të mbledhjes, si dhe drejtimin e diskutimeve. Ata zgjidhen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen.
3. Në mungesë të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Nenkryetari, ose në mungesë të Nenkryetarit, nga një anëtar tjetër i Këshillit me vendim të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Sekretari i Korporatës shërben edhe si Sekretar për Bordin.

Neni 30

Kompetencat e Bordit Këshillimor

1. Bordi ka funksion këshillues në raport me Këshillin, Drejtorin Ekzekutiv, dhe Asamblenë.
2. Këshilli dhe Drejtori Ekzekutiv kanë për detyrë informimin dhe bashkëpunimin me Bordin mbi iniciativat, projektet e propozuara për Korporatën dhe aktivitetet e tjera të saj.
3. Bordi informon rregullisht nëpërmjet opinioneve dhe rekomandimeve Këshillin, Drejtorin Ekzekutiv, dhe Asamblenë mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të punës së Korporatës.
4. Bordi mund të krijojë komitete të specializuara për të kryer detyrat e tij, aktiviteti i të cilëve rregullohet me akte të tjera të brendshme të miratuara nga Këshilli me propozim të Bordit.
5. Bordi vepron me iniciativën e tij, me kërkesë të Këshillit, Drejtorit Ekzekutiv, ose Asamblesë.

Neni 31

Mbledhjet e Bordit Këshillimor

1. Të gjitha mbledhjet e Bordit mbahen në selinë e Korporatës apo në një vend tjetër, sipas kërkesës së drejtuesit të mbledhjes apo të shumicës së anëtarëve të tij.

2. Bordi mbledhet rregullisht të paktën dy herë në vit, sa herë që e kërkon interesi i Korporatës, me kërkesë të Kryetarit apo tre prej anëtareve të tij, Këshillit ose Drejtorit Ekzekutiv.
3. Kuorumi për mbledhjet e Bordit arrihet nëse pesë nga nëntë anëtarët e tij janë të pranishëm, dy nga të cilët duhet të jenë anëtarë të pavarur, personalisht ose përmes lidhjeve të tjera, si telekonferencë ose mjete të ngjashme të komunikimit.
4. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të marrë pjesë në një takim personalisht, Bordi do të lehtësojë lidhjet me mjete të tjera të mundshme, përfshirë telekonferencën ose mjete të ngjashme të komunikimit.
5. Mbledhjet e Bordit mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës apo me mjete të ngjashme komunikimi, me kusht që anëtarët e tjerë të kenë mundësi të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara. Në këtë rast, mbledhja e Bordit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet drejtuesi i mbledhjes.

Neni 32

Aftësia për të vepruar gjatë periudhës midis mbledhjeve

1. Bordi mund të përdorë të gjitha mjetet e mundshme për të ushtruar funksionet e tij, në rast pamundësie të organizimit të mbledhjeve.
2. Gjatë periudhës ndër-sesionale, Bordi vazhdon të ushtrorë funksionet e tij dhe të kryejë aktivitetet, sipas nevojës.
3. Bordi mund të kërkojë nga Sekretari i Korporatës ndihmë për kryerjen e funksioneve të tij. Sekretari ka detyrimin të respektojë kërkesen e Bordit për ndihmë.

Neni 33

Njoftimi i Mbledhjes

1. Njoftimi i mbledhjes, i nënshkruar nga pala apo palët thirrëse, në të cilin përcaktohen ora, dita, vendi, si dhe rendi i ditës, duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të Bordit nëpërmjet postës së zakonshme dhe postës elektronike të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen. Ky afat mund të zvogëlohet në 48 (dyzet e tetë) orë, në raste urgjence.
2. Mbledhja e Bordit quhet e thirrur rregullisht edhe pa përmbushur këto formalitete, nëse të gjithë anëtarët e Bordit janë të pranishëm në mbledhje.
3. Pala apo palët thirrëse vënë, gjithashtu, në dispozicion të çdo anëtari të Bordit të gjithë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, për çështjet që trajtohen, të paktën 7 (shtatë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen dhe, në rast urgjence, 48 (dyzet e tetë) orë përpara.

Neni 34

Vendimarrja

1. Bordi synon të formulojë opinione dhe rekomandime bazuar në konsensus. Në rast kur nuk mund të arrihet konsensus, Bordi formulon qëndrimet e tij me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Në rast barazie votash, vota e drejtuesit të mbledhjes është vendimtare.

3. Bordi informon Këshillin, Drejtorin Ekzekutiv dhe Asamblenë për opinionet dhe rekomandimet e tij.

Neni 35 Protokolli

Sekretari mban procesverbale të mbledhjeve të Bordit.

Neni 36 Komitetet e Posaçme

1. Këshilli mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e tij, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet, apo për të zbatuar ose mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratës dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Sipas rastit, në komitete mund të marrin pjesë edhe zyrtarë të Korporatës.
2. Në zbatim të ligjit Nr. 71/2019, Këshilli krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Korporatë.
3. Çdo Komitet zhvillon veprimtarinë e tij në funksion të qëllimit për të cilin është formuar sipas rregullave të funksionimit përcaktuara në këtë Statut dhe akte të tjera të brendshme.
4. Këshilli miraton rregulloren e funksionimit të komiteteve të posaçme.
5. Këshilli mund të ftojë anëtarë nga Bordi për të marrë pjesë në komitetet e posaçme, pa të drejtë vote, si dhe të këshillohet me ekspertë të jashtëm.
6. Komitetet raportojnë në Këshill.
7. Me përjashtim të çështjeve që kërkojnë vendimarrje në Këshill, Këshilli siguron zbatimin e vendimeve të komiteteve dhe/ose reflektimin e rekomandimeve të tyre.

Neni 37 Komiteti i Auditimit (Kontrollit të Brendshëm)

1. Këshilli krijon Komitetin e Kontrollit të Brendshëm të përbërë nga jo më pak se tre anëtarë të tij, nga të cilët dy janë anëtarë të pavarur. Ai ka për detyrë të mbikëqyrë dhe sigurohet për pavarësinë dhe profesionalizmin e Auditimit të Brendshëm, dhe raporton tek Këshilli.
2. Secili anëtar i komitetit duhet të ketë eksperiencë relevante të fushës dhe të jetë në gjendje të kuptojë pasqyrat financiare vjetore, bilancin e konsoliduar dhe raportet e performances.
3. Komiteti mund të këshillohet nga ekspertë të jashtëm, nga të cilët një duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale në kontabilitet.
4. Kryetari i komitetit caktohet nga anëtarët e pavarur të Këshillit.
5. Kryetari i Këshillit nuk mund të shërbejë në komitet.
6. Roli kryesor i komitetit është të mbikëqyrë procesin e raportimit financiar dhe transparencën. Për të përmbushur këtë detyrim, komiteti duhet:
 - a) të kryejë kontrollin e veprimtarisë së Korporatës dhe të paraqesë raporte me shkrim, sipas kërkesave të Këshillit;

- b) të kontrollojë përgatitjen dhe saktësinë e menaxhimit të pasqyrave financiare të Korporatës;
- c) të emerojë, vlerësojë dhe shkarkojë Audituesin e Brendshëm për të siguruar pavaresinë nga drejtuesit;
- d) të kontrollojë saktësinë e raporteve të Audituesit Ligjor, të vlerësojë cilësinë dhe të sigurohet për pavarësinë e tij;
- e) të mbikëqyrë menaxhimin e kontrolleve dhe procedurave efektive të brendshme për të siguruar përputhjen e veprimtarisë së Korporatës me standardet e kontabilitetit, procedurat e raportimit financiar dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- f) të rishikojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Korporatës, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme ose dobësi materiale në hartimin ose funksionimin e saj, çdo ndryshim material në kontrollet e brendshme, çdo fazë të veçantë të auditimit të miratuar në dritën e ndonjë mangësie të kontrollit material, çdo mashtrim që përfshin administrimin ose punonjës të tjerë me rol të rëndësishëm në kontrollet e brendshme, dhe të shqyrtojë dhe diskutojë me administratën në lidhje me kontrollet e brendshme të Korporatës dhe kërkesat për transparencën dhe dhënien e informacionit;
- g) të vendosë dhe mbikëqyrë procedurat për pranimin, ruajtjen dhe trajtimin e ankesave të ardhura në Korporatë në lidhje me kontabilitetin, kontrollet e kontabilitetit të brendshëm ose çështjet e auditimit dhe çështjet konfidenciale, nga punonjësit e Korporatës për shqetësimet në lidhje me çështjet e kontabilitetit ose auditimit;
- h) të rishikojë dhe diskutojë me organet drejtuese risqet me të cilat përballet Korporata dhe politikat, udhëzimet dhe procesin me të cilin administrata e Korporatës vlerëson dhe administron risqet, përfshirë ekspozimet kryesore të riskut financiar dhe hapat që administrata ka ndërmarrë për të monitoruar dhe kontrolluar ekspozimet e tilla;
- i) përgatitjen dhe zbatimin e politikës për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e tyre;
- j) detyra të tjera që mund ti caktohen nga Këshilli ose të përcaktuara në akte të tjera të brendshme.

Neni 38

Komiteti i Përputhshmërisë Ligjore dhe Etikës

1. Këshilli krijon Komitetin e Përputhshmërisë Ligjore dhe Etikës të përbërë nga jo më pak se tre anëtarë të tij, nga të cilët dy janë anëtarë të pavarur.
2. Secili anëtar i komitetit duhet të ketë eksperiencë relevante të fushës.
3. Roli kryesor i komitetit është të zhvillojë dhe të ruajë politikat e përputhshmërisë ligjore. Për të përmbushur këtë detyrim, komiteti duhet:
 - a) të ushtrojë përgjegjësitë e deleguara nga Këshilli në lidhje me politikat e përputhshmërisë ligjore të Korporatës;
 - b) të mbikëqyrë praktikën dhe procedurat e qeverisjes korporative të Korporatës, duke përfshirë identifikimin e praktikave më të mira dhe rishikimin dhe rekomandimin e organeve drejtuese për miratimin e çdo ndryshimi në dokumentet, politikat dhe procedurat e qeverisjes të Korporatës;

- c) të zhvillojë, duke iu nënshtruar aprovimit nga Këshilli, një proces për vlerësimin vjetor të Këshillit, Bordit, dhe komiteteve të tyre, si dhe zyrtarëve të Korporatës, dhe për të mbikëqyrur kryerjen e këtij vlerësimi vjetor;
- d) të rishikojë strukturën dhe përbërjen e komiteteve të organeve drejtuese dhe t'i bëjë rekomandime secilit organ lidhur me emërimin e anëtarëve për të shërbyer si anëtarë të secilit komitet;
- e) të zhvillojë dhe mbikëqyrë një program të orientimit të Korporatës për anëtarët e rinj të organeve drejtuese dhe një program arsimimi të vazhdueshëm për anëtarët aktualë të tyre, të rishikojë në mënyrë periodike këto programe dhe përditësojë ato sipas nevojës;
- f) të rishikojë të gjitha kompensimet e anëtarëve të organeve drejtuese dhe zyrtarëve të paktën një herë në vit dhe të rekomandojë çdo ndryshim në Këshill, nëse është e nevojshme;
- g) të zhvillojë Kodin e Qeverisjes së Mirë dhe Etikës dhe monitorojë pajtueshmërinë me të, për të hetuar çdo shkelje të pretenduar, dhe për të zbatuar dispozitat e Kodit;
- h) detyra të tjera që mund të caktohen nga Këshilli ose të përcaktuara në akte të tjera të brendshme.

Neni 39 Komiteti i Investimeve

1. Këshilli krijon Komitetin e Investimeve të përbërë nga jo më pak se pesë anëtarë, nga Këshilli dhe zyrtarët e Korporatës. Shumicën në komitet e kanë anëtarët e Këshillit, nga të cilët dy janë anëtarë të pavarur.
2. Secili anëtar i komitetit duhet të ketë eksperiencë relevante të fushës.
3. Roli kryesor i komitetit është të mbikëqyrë zbatimin dhe performancën e projekteve të investimeve të Korporatës. Për të përmbushur këtë detyrim, komiteti duhet:
 - a) të krijojë një politike investimi për Korporatën, përfshirë procedurat dhe kriteret për miratimin, zbatimin, vlerësimin dhe monitorimin e projekteve të investimeve;
 - b) të vlerësojë dhe monitorojë performancën e projekteve të investimeve;
 - c) të rishikojë raportet e menaxhimit për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimeve të Korporatës;
 - d) të formulojë, dhe zbatojë në bashkëpunim me zyrtarët e Korporatës politikën e riskut lidhur me projektet e Korporatës;
 - e) detyra të tjera që mund të caktohen nga Këshilli ose të përcaktuara në akte të tjera të brendshme.

Neni 40 Zyrtarët

1. Përveç Drejtorit Ekzekutiv, zyrtarët e Korporatës janë: a) Drejtori i Financës, b) Drejtori i Operacioneve, c) Sekretari, d) Audituesi i brendshëm, si dhe zyrtarë të tjerë të nevojshëm për funksionimin e Korporatës, specifikimi i të cilëve bëhet me akte të tjera të brendshme të Korporatës. Zyrtarët emërohen nga Këshilli.
2. Struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli. Marrëdhëniet e punës së personelit të Korporatës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

3. Këshilli duhet të konsultohet me Bordin për emërimin dhe shpërblimin e zyrtarëve.
4. Zyrtari mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, me shkrim, drejtuar Këshillit ose Sekretarit. Dorëheqja hyn në fuqi në kohën e përcaktuar në të.
5. Zyrtarët shërbejnë në diskrecionin e Këshillit, dhe i nënshtrohen treguesve kryesorë të performancës dhe kontratës individuale.
6. Në rast se një zyrtar mungon apo në rast pamundësie kryerje të detyrës, Këshilli mund të delegojë përkohësisht kompetencat ose detyrat e këtij zyrtari tek ndonjë zyrtar tjetër ose tek ndonjë nga anëtarët e Këshillit.

Neni 41

Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Financës

Drejtori i Financës ka kompetencë dhe kryen detyrat e caktuara nga Këshilli dhe Drejtori Ekzekutiv, të cilat mund të përfshijnë, pa kufizime:

1. kryerjen e veprimeve financiare të Korporatës në përputhje me planin e biznesit, buxhetin, dhe planin vjetor;
2. kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të librave të Korporatës;
3. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e performancës, së bashku me propozimet e investimeve në lidhje me fitimet;
4. dhënie e asistencës për Drejtorin Ekzekutiv, Këshillin dhe Bordin për planifikimin strategjik;
5. detyra të tjera që mund të përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës.

Neni 42

Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Operacioneve

Drejtori i Operacioneve ka kompetencë dhe kryen detyrat e caktuara nga Këshilli dhe Drejtori Ekzekutiv, të cilat mund të përfshijnë, pa kufizime:

1. përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimit të Korporatës;
2. këshillimin e institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, rekomandimin, dhe strukturimin e projekteve;
3. dhënie e asistencës për Drejtorin Ekzekutiv, Këshillin Mbikëqyrës dhe Bordin Këshillimor për planifikimin strategjik;
4. detyra të tjera që mund të përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës.

Neni 43

Përgjegjësitë dhe detyrat e Sekretarit

Sekretari ka kompetencë dhe kryen detyrat e caktuara nga Këshilli dhe Drejtori Ekzekutiv, të cilat mund të përfshijnë, pa kufizime:

1. të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve drejtuese, dhe të regjistrojë të gjitha votat dhe procesverbalet e procedurave në një libër që duhet të mbahen për atë qëllim, si dhe të kryejë detyra për komitetet e krijuara, kur kërkohet;
2. njoftimin për të gjitha mbledhjet e organeve drejtuese;

3. mbajtjen me kujdes të vulës së Korporates, si dhe autorizohet për të vendosur vulën në të gjitha dokumentet që e kërkojnë atë nga personat që kanë të drejtën e nënshkrimit;
4. detyra të tjera që mund të përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës.

Neni 44

Përgjegjësitë dhe detyrat e Audituesit të Brendshëm

Audituesi i Brendshëm ka kompetencë dhe kryen detyrat e caktuara nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli, të cilat mund të përfshijnë, pa kufizime:

1. kontrollon në vazhdimësi veprimtarinë e Korporatës në përputhje me praktikat më të mira dhe planin e kontrollit të brendshëm të miratuar nga Komiteti i Auditimit;
2. raporton dhe ndihmon Komitetin e Auditimit në auditimin e Korporatës;
3. siguron që transaksionet janë në përputhje me kërkesat e rregulloreve të Korporatës, vendimet e Asamblesë, Këshillit dhe Drejtorit Ekzekutiv;
4. bashkëpunon me Kontrollin e Lartë të Shtetit duke dërguar raportet që kërkohen;
5. jep informacion në kohë, me shkrim, për Asamblenë, Këshillin ose Drejtorin Ekzekutiv, sipas rastit, për parregullsitë që ndodhin në funksionimin e Korporatës dhe veprimet e saj;
6. detyra të tjera që mund të përcaktohen nga aktet e brendshme të Korporatës.

Neni 45

Audituesi Ligjor

1. Asambleja emëron një ose më shumë auditues ligjor të jashtëm e të pavarur, të cilët kanë fituar këtë titull sipas ligjit. Audituesit ligjor emërohen për një periudhë tre vjeçare pa të drejtë riemërimi për të paktën tre vite.
2. Audituesit ligjor kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Asambleja e Përgjithshme emëron Auditues ligjor/ekspert kontabël të regjistruar, Shoqërinë "DELOITTE AUDIT ALBANIA" SHPK.

Neni 46

Kompetencat dhe detyrat e zyrtarëve të tjerë

Kompetencat dhe detyrat e të gjithë zyrtarëve të tjerë të Korporatës do të jenë ato që zakonisht kanë të bëjnë me pozicionet e tyre përkatëse, në varësi të drejtimit dhe kontrollit të Këshillit dhe siç parashikohet në aktet e tjera të brendshme.

TITULLI IV

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 47

Viti financiar dhe ndarja e dividendëve

1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore të miratuara nga Asambleja, shpërndahen, si më poshtë vijon:
 - a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të nenshkruar;
 - b) pjesa e mbetur me vendim të Asamblesë riinvestohet në Korporatë ose në fonde të tjera rezervë.
3. Asambleja mund të vendosë që fitimet të riinvestohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe me politikën për dividendët.

Neni 48 **Kontabiliteti**

1. Korporata mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde kontabiliteti, sipas ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.
4. Kontrolli i Lartë i Shtetit kryen auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronave publike ose shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiare të shtetit, në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronjën "e" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Auditit të Lartë të Shtetit."

Neni 49 **Regjistrat dhe Librat**

1. Korporata do të mbajë a) libra dhe regjistrime të sakta dhe të plota të llogarive; b) procesverbalet e punimeve të organeve drejtuese dhe çdo komiteti; c) një listë aktuale të anëtarëve të organeve drejtuese dhe zyrtarëve dhe adresat e vendbanimit të tyre.
2. Këshilli mund të përcaktojë nëse llogari, libra, regjistrime ose dokumente të tjera të Korporatës do të jenë të hapura për inspektim.
3. Korporata publikon në faqen e saj zyrtare raportin vjetor, pasqyrat financiare të audituara, informacion mbi llojin e investimeve, dhe performancën e saj sipas treguesve kryesore.

Neni 50 **Kontrollet dhe shënimet**

Korporata rregjistron të gjitha kontrollet, draftet, dhe tërheqjet nga llogaritë e saj me bankat ose institucionet e tjera financiare, dhe të gjitha faturat e këmbimit, shënimet dhe instrumentet e tjera për pagimin e parave, të tërhequra, të bëra, të miratuara ose të pranuar nga ajo.

Neni 51 **Prishja, ndarja dhe bashkimi**

Korporata mund të prishet, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar. Me propozimin e Këshillit, Asambleja vendos për ndarjen, bashkimin, ose prishjen e Korporatës.

Neni 52 Likuidimi

1. Në rast prishjeje, Korporata kalon në procedurë likuidimi.
2. Në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin përfundimtar për aktivet dhe detyrimet e Korporatës dhe për procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin.
3. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja vendos për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
4. Pasuritë e mbajtura me kusht që kërkon kthim ose transferim e tyre në momentin e shpërbërjes së Korporatës, kthehen ose transferohen siç kërkohet nga kushti në fjalë.
5. Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit i shpërndajnë pasuritë e mbetura aksionerëve.
6. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e Korporatës, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Neni 53 Konflikti i interesit

1. Kur një anëtar i organeve drejtuese, zyrtar ose punonjës i Korporatës ka një interes financiar ose personal për çdo çështje që vjen për mendim ose vendim në Korporatë, personi i prekur do të a) zbulojë plotësisht natyrën e interesit dhe b) tërhiqet nga diskutimi, lobimi dhe votimi i çështjes.
2. Çdo transaksion ose votë që përfshin një konflikt të mundshëm interesi do të miratohet vetëm kur shumica e anëtarëve të përcaktojnë se është në interesin më të mirë të Korporatës ta bëjë këtë. Procesverbali i mbledhjeve në të cilat merren vendime të tilla do të regjistrojë rezervimin dhe konfliktin e interesit, abstenim dhe arsyetim për miratim.
3. Informacioni lidhur me konfliktin e interesit përfshihet në raportin vjetor.
4. Komiteti i Përputhshmërisë Ligjore dhe Etikës ndjek çështjet lidhur me konfliktin e interesit.

Neni 54 Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Legjislacioni Shqiptar është i zbatueshëm dhe gjykatat Shqiptare kanë juridiksion mbi Korporatën, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në akte të tjera të brendshme dhe/ose kontrata individuale.

Neni 55

Dispozita përfundimtare

Çështjet, të cilat nuk parashikohen shprehimisht nga ky Statut, rregullohen nga ligji nr. 71/2019 "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ose në akte të tjera të brendshme të Korporatës.

Tiranë më, 15.07.2020

Aksionari themelues i vetëm

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

MINISTËR

Anifa Denaj
